

Matura Shtetërore 2017
UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARËVE A1 & A1Z

Formulari A1

1. **Formulari A1** plotësohet online. Procedura e plotësimit online do të bëhet sipas një udhëzimi të veçantë.
2. **Formularin A1** e plotësojnë vetëm maturantët e vitit shkollor 2016 – 2017.
3. Plotësimi i **Formularit A1** fillon në Portalin Qeveritar, dhe përfundon në shkollë.
4. Procesi i plotësimit të **Formularit A1** në shkollë ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet “mbikëqyrës”.
5. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi fut kodin në sistem, maturanti mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1** në shkollë.
6. Lista me të dhënat e marra nga plotësimi i formularëve printohet, nënshkruhet nga maturanti e mbikëqyrësi dhe vulloset nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1. Listat ruhen deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2017.

I. TË DHËNA PERSONALE

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 1**, (numri personal i letërnjoftimit ID), maturanti shënon numrin e tij personal që ka në dokumentin e identifikimit.
Për të dhënat **2-5**, pasi maturanti bën plotësimin, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.
- **Tek pika 6**, maturanti shënon në fushat përkatëse, numrin e telefonit dhe adresën e email-it, të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2017, me qëllim që maturanti të marrë informacion në faza të ndryshme të procesit. Nëse maturanti nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë mbikëqyrësi shënon numrin e tij të telefonit.
- **Tek pika 7**, shënohet X tek kutizat pranë Po ose Jo.

II. TË DHËNA SHKOLLORE

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikëqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi. Për plotësimin saktë të kërkesave të këtij grupimi, maturanti dhe mbikëqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për secilën nga rubrikat përkatëse:

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 8**; (emri i qytetit/fshatit), maturanti shënon emrin e qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku po ndjek studimet.
- **Tek pika 9**; (emri i shkollës ku studion), maturanti shënon emrin e shkollës ku po studion.

Plotësohen nga mbikëqyrësi.

- **Tek pika 10**, mbikëqyrësi plotëson emrin e DAR/ZA-së përkatëse.
- **Tek pika 11**, (indeksi i profilit), mbikëqyrësi zgjedh nga lista numrin dyshifror që i përket shkollës ku ndjek studimet maturanti, sipas listës së miratuar nga MAS.
- **Tek pika 12**, (emërtimi i profilit) mbikëqyrësi plotëson emrin e profilit/degës.
- **Tek pika 13**, mbikëqyrësi plotëson klasën dhe paralelin e klasës ku po studion maturanti.
- **Tek pika 14**, zgjidhet nga lista, gjuha e huaj që në planin mësimor të shkollës trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar, në nivelin gjuhësor B1.

III. TË DHËNA LËNDORE

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 15**, maturanti zgjedh nga lista lëndët Z1 dhe Z2 që dëshiron të japë provim.
- Zgjedhja e lëndëve Z1 dhe Z2 bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 26, datë 29.12.2016, të MAS dhe MMSR.
- Numri i lëndëve që do të zgjidhen duhet të jetë detyrimisht 2 (dy).
- Shuma e krediteve të dy lëndëve që zgjidhen, duhet të jetë jo më e vogël se 8 (tetë).
- Kur zgjidhet një lëndë bërthamë, nuk mund të zgjidhet e njëjta lëndë e thelluar (përfshirë lëndët e detyruara).
- Maturanti ka të drejtë të zgjedhë si lëndë me zgjedhje, gjuhën e huaj të cilën parapëlqen nëse e ka zhvilluar ose jo në shkollë, në nivelin gjuhësor B2.
- Maturantët e shkollave artistike mund të zgjedhin vetëm një të njërit nga lëndët e grupit II: “Për shkollat artistike”. Lëndën tjetër duhet ta zgjedhin nga grupi i lëndëve të grupit I “Për shkollat e mesme (Gjimnazet)”.
- Teoria profesionale është e zberthyer në profile sipas indeksit të shkollave.
- Maturantët e shkollave profesionale duhet të zgjedhin detyrimisht një të njërit nga lëndët me zgjedhje në grupin II “Teoria profesionale e integruar me zgjedhje të detyruar” dhe lëndën tjetër e zgjedh nga grupi i I “Për shkollat e mesme (Gjimnazet)”.

Formulari A1Z

7. **Formulari A1Z** plotësohet online. Procedura e plotësimit online do të bëhet sipas një udhëzimi të veçantë.
8. Plotësimi i **Formularit A1Z** fillon në Portalin Qeveritar, dhe përfundon në shkollë.
9. Formulari A1Z plotësohet nga:
 - a) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2017 dhe që kanë detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore;
 - b) Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit dhe, pasi kanë bërë njehsimin e diplomës në komisionin përkatës të MAS, rezulton se kanë detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore.
 - c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri ose jashtë vendit, që nuk kanë detyrim për të dhënë provime në MSh 2017, por që duan të vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL).
10. Procesi i plotësimit të **Formularit A1Z** në shkollë ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që do të quhet “mbikëqyrës”.
11. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi fut kodin në sistem, kandidati mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1Z**.
12. Kandidatët për të plotësuar formularin A1Z, duhet të paraqesin tek mbikëqyrësi një vërtetim të lëshuar nga shkolla ku ka dhënë provimet. Vërtetimi, veç gjeneraliteteve duhet të ketë edhe këto të dhëna:
 - a) Provimet e detyruara dhe vlerësimet e shkallëzuara të secilit provim, nëse ato rezultojnë të fituara nga kandidati.
 - b) Provimet me zgjedhje dhe vlerësimet e shkallëzuara të secilit provim, nëse ato rezultojnë të fituara nga kandidati.Vërtetimi pas përfundimit të aplikimit i bashkëngjitet kopjes së formularit A1Z, që mban shkolla dhe dorëzohet në AKP 5 ditë pas përfundimit të aplikimeve.
13. Lista me të dhënat e marra nga plotësimi i formularëve printohet, nënshkruhet nga maturanti e mbikëqyrësi dhe vuloset nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1Z. Listat ruhen deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2017.

I. Të dhënat personale

Plotësohen nga kandidati

- **Tek pika 1**, (numri personal i letërnjoftimit ID), kandidati shënon numrin e tij personal që ka në dokumentin e identifikimit.
Për të dhënat **2-5**, pas plotësimit nga kandidati, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.

- **Tek pika 6**, kandidati shënon në fushat përkatëse, numrin e telefonit dhe adresën e email-it, të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2017, me qëllim që kandidati të marrë informacion në faza të ndryshme të procesit.
Nëse kandidati nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë mbikëqyrësi shënon numrin e tij të telefonit.
- **Tek pika 7**, kandidati zgjedh nga lista Po ose Jo.

II. Të dhëna shkollore

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikëqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi. Për plotësimin saktë të kërkesave të këtij grupimi, kandidatët dhe mbikëqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për rubrikat përkatëse:

Plotësohen nga kandidati

- **Tek pika 8;** (emri i qytetit/fshatit), kandidati shënon emrin e qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku ai ka studiuar.
- **Tek pika 9;** (emri i shkollës ku ka studiuar), kandidati shënon emrin e shkollës ku ai ka përfunduar studimet.

Plotësohen nga mbikëqyrësi

- **Tek pika 10**, mbikëqyrësi plotëson emrin e DAR/ZA-së përkatëse.
- **Tek pika 11**, (Indeksi i profilit), zgjidhet nga lista numri dyshifror që i përket shkollës ku ka studiuar kandidati ose ai që përcaktohet nga komisioni i njehsimit të diplomave për shtetasit që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, sipas listës së miratuar nga MAS.
- **Tek pika 12**, (emërtimi i profilit) mbikëqyrësi plotëson emrin e profilit/degës.

III. Të dhëna lëndore

Plotësohen nga mbikëqyrësi

Zgjedhja e lëndëve bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 26, datë 29.12.2017 të MAS dhe MMSR.

Të dhënat e mëposhtme mbikëqyrësi i plotëson mbështetur në vërtetimin e përmendur në pikën 6 të këtij udhëzimi:

- ID e kandidatit: Shënohet ID që kandidati ka marrë në maturat e mëparshme. Nëse nuk ka marrë ID ose nuk e mban mend, fusha të mbetet bosh.
- Viti i përfundimit të shkollës së mesme: (zgjidhet nga lista “Viti i përfundimit të shkollës së mesme”).
- Nëse ka marrë dëftesë pjekurie të shënojë **Po**, nëse nuk ka marrë dëftesë pjekurie të shënojë **Jo**.

Lëndët e detyruara

➤ Lëndët e detyruara që mbarten:

Lënda D1: Në këtë fushë shfaqet “Letërsi”. Mbikëqyrësi plotëson notën e shkallëzuar të kësaj lënde, që i njihet apo i është konvertuar nga komisioni përkatës, si lëndë D1.

Lënda D2: Në këtë fushë shfaqet “Matematikë”. Mbikëqyrësi plotëson notën e shkallëzuar të kësaj lënde, që i njihet apo i është konvertuar nga komisioni përkatës, si lëndë D2.

➤ Lëndët e detyruara që do zgjidhen:

Nëse kandidati mbart lëndën D1, ai do të japë provim vetëm D2, prandaj zgjidhet “Lënda D2”.

Nëse kandidati mbart lëndën D2, ai do të japë provim vetëm D1, prandaj zgjidhet “Lënda D1”.

Nëse kandidati mbart të dy lëndët D1 dhe D2, nuk do të zgjidhet as “Lënda D1” e as “Lënda D2”.

Lëndët me zgjedhje:

➤ Mbartja e lëndëve me zgjedhje:

Lënda Z1: Zgjedh nga lista lëndën Z1 që do të mbartë dhe shënon vitin kur e ka dhënë dhe notën e shkallëzuar të saj.

Lënda Z2: Zgjedh nga lista lëndën Z2 që do të mbartë dhe shënon vitin kur e ka dhënë dhe notën e shkallëzuar të saj.

Nëse lënda/lëndët e mbartura janë dhënë disa herë provim, do të mbartet nota e marrë në vitin e fundit.

➤ Zgjedhja e lëndëve me zgjedhje:

- a) Kandidati që mbart nga maturat e viteve 2006-2016 dy lëndë me zgjedhje, nuk do të japë provim me zgjedhje.
- b) Kandidati që mbart nga maturat e viteve 2006-2016 një lëndë me zgjedhje, duhet të zgjedhë për të dhënë provim vetëm një lëndë me zgjedhje, në përputhje me Udhëzimin Nr. 26, datë 29.12.2016 të MAS dhe MMSR.
- c) Kandidati që nuk ka mbartur lëndë me zgjedhje nga maturat para vitit 2017, duhet të zgjedhë për të dhënë provim dy lëndë, nga lista e lëndëve me zgjedhje, në përputhje me Udhëzimin Nr. 26, datë 29.12.2016 të MAS dhe MMSR.

Dy lëndët e zgjedhura duhet të plotësojnë kushtin, jo më pak se 8 kredite.